

## Leje qëndrimi ose çertifikatë për shkak të abuzimit nga punëdhënësi

Nëse ke qenë viktimë e abuzimit dhe shkeljes së theksueshme të së drejtave tuaja nga punëdhënësi, ke mundësi për të aplikuar për vazhdimin e lejes ose për një çertifikatë, për të zgjeruar të drejtën e punës si dhe për të ndryshuar punëdhënësin. Për këtë, duhet pasur lejen e qëndrimit në Finlandë, ku përfshihet e drejta për të punuar.

Nuk ke mundësi për të aplikuar për leje ose çertifikatë, nëse ke punuar në Finlandë me çertifikatë për punë sezonale ose pa leje qëndrimi.

Nëse të vazhdohet leja ose të jepet çertifikata, për shkak të abuzimit nga punëdhënësi, ti ke mundësi për të punuar në çdo lëmi. Kështu pra ti ke të drejtën e pakufizuar për të punuar.

### Apliko për vazhdimin e lejes ose për çertifikatë për shkak të abuzimit nga punëdhënësi

**Apliko për vazhdimin e lejes nëse leja aktuale e qëndrimit është gati të përfundojë dhe nuk ke informacione për punëdhënësin tënd të ri**

Vazhdimi i lejes të mundësohet me qëllim aplikimi për punë ose për aktivitet afarist për një vit. Vlefshmëria e saj fillon në datën e përfundimit të lejes suaj të mëparshme të qëndrimit. Lexo [udhëzimet e aplikimit për vazhdimin e lejes për shkak të abuzimit nga punëdhënësi](#).

**Apliko për çertifikatë, nëse ke leje qëndrimi akoma të vlefshme dhe ke marrëveshje me punëdhënësin e ri**

Çertifikata e të drejtës së zgjeruar për punë të mundëson me u largue më lehtë nga shërbimi ndaj punëdhënësit tuaj aktual për të filluar punën te punëdhënësi tjetër. Lexo [udhëzimet e aplikimit për çertifikatën për shkak të abuzimit të punëdhënësit](#).

### Shkejla e të drejtave dhe abuzimi i konsiderueshëm nga punëdhënësi mund të nënkuptojë, për shembull, që

- ti duhet për të punuar padrejtësishtë me orar më të gjatë
- punëdhënësi yt nuk të ka paguar pagën në përputhje me kontratën e punës

- punëdhënësi kërcënon jetën ose shëndetin tënd dhe të familjarëve tuaj.

Shikoje [listën gjithëpërfshirëse të asaj që mund të nënkuptojë shkelje e të drejtave dhe abuzimeve nga punëdhënësi.](#)

Gjatë punës në Finlandë duhet të zbatohen ligjet finlandeze. Kjo do të thotë që asnjë punonjës nuk duhet t'i nënshtrohet, p.sh, pagës padrejtësishtë të ulët ose kushteve të rrezikshme në punën e tij.

## **Nëse ke një anëtar të familjes që ka leje qëndrimi në Finlandë bazuar në lidhjet familjare,**

statusi i tij i qëndrimit mbetet i njëjtë, edhe nëse e merr vazhdimin e lejes ose çertifikatën për shkak të abuzimit nga punëdhënësi. Megjithatë, të ardhurat e anëtarit të familjes suaj duhet në vazhdimësi të sigurohen, nëse ai më vonë aplikon për vazhdimin e lejes.

## **Si ndryshon leje qëndrimi për shkak të abuzimit nga punëdhënësi prej leje qëndrimit në rastin e viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore?**

Leje qëndrimi ose çertifikata për shkak të abuzimit nga punëdhënësi u jepet vetëm personave të cilët edhe para kësaj kanë pasur leje qëndrimi në Finlandë, e cila përfshin të drejtën për të punuar. Ndërsa leje qëndrimi për një viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore mund të ju jepet edhe personave që para kësaj nuk kanë pasur leje qëndrimi në Finlandë. Lexo më shumë [rreth lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.](#)

## **Të dhëna shtesë**

[Probleme në raportet tuaja me punën?](#)